



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PA1.nr.1032/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me sekretaren juridike Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.SH., nga fshati Bozhlan, Komuna e Vushtrrisë, për shkak të tre veprave penale të vjedhjes së pyllit nga neni 358 par.2 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.334/2020 të dt.18.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me 27.01.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.334/2020 të dt.18.09.2020, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.334/2020 të dt.18.09.2020, është shpallur fajtor i akuzuari B.SH., për shkak të tre veprave penale të vjedhjes së pyllit nga neni 358 par.2 të KPK, dhe atë:

- për veprën e parë penale i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej nga 200 (dyqind)Euro si dhe dënimi me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti;

- për veprën e dytë e dytë penale i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej nga 200 (dyqind)Euro si dhe dënimi me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti;

- për veprën e parë penale i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej nga 200 (dyqind)Euro si dhe dënimi me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti.

Gjykata e shkallës së parë të akuzuarit për të tre veprat penale i ka shqiptuar dënimin unik me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind)Euro, të cilin dënim i akuzuari është obliguar ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i

akuzuari nuk dëshiron apo nuk mundet të paguajë dënimin me gjobë, i njëjti në kuptim të nenit 43 par.3 të KPK dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve, duke i llogaritur nga 20 (njëzet)Euro për çdo ditë të kaluar në burgim. Gjithashtu i është shqiptuar edhe dënimi me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 24 (njëzet e katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 3 (tre) viteve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë)Euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të kimit të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë)Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Është obliguar i akuzuari që të dëmtuarës Komuna e Vushtrrisë – Drejtoria për Zhvillim, Bujqësi dhe Zhvillim Rural – Sektori i Pylltarisë, në emër të kërkesës pasurore juridike të ia paguaj shumën prej 1632.60 (njëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy Euro e gjashtëdhjetë Cent), për kompensimin e dëmit të shkaktuar.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit lidhur sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.1045/2020, të datës 06.01.2021, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nuk është e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese sikurse janë fakti se i akuzuari veprat penale i ka kryer gjatë një periudhe kohore duke prerë pyllin shtetëror ashtu që ka shkaktuar edhe dëm të madh material, e po ashtu faktin se vepra penale e

vjedhjes së pyllit është në rritje e sipër dhe se me dënime të tilla të buta nuk po arrihet qëllimi i dënimit, e gjithashtu si rrethanë posaçërisht rënduese është dashur të vlerësohet edhe se i akuzuari është recidivist pasi që i njëjti ka kryer disa vepra penale të vjedhjes së pyllit, andaj në prani të këtyre rrethanave konsiderojmë se me dënimin e shqiptuar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar nuk mund të arrihet as efekti dhe as qëllimi i dënimit, prandaj i propozojmë kolegjit të kësaj gjykate që ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim më i ashpër.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale e cila i vihen në barrë, e gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe rrethanat lehtësuese, sikurse edhe ato rënduese, ashtu që me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, ashtu që si rrethana lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, se i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të kësaj natyre apo natyrës tjetër, se është i gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës i familjes dhe kohë pas kohe me vizë pune punon në Kroaci, ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar shkallën e pjesëmarrjes së të akuzuarit në kryerjen e të tre veprave penale, rrezikimin apo dëmtimin e vlerës së mbrojtur përkatësisht të dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar, si dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e intensitetit të së njëjtës, ka vlerësuar edhe ankesën e ushtruar nga Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nga e cila nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1032/2020, të datës 27.01.2021

Sekretarja juridike,
Fitnete Hoti

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri